



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 21.07.20

Ref.: 984/200

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 82, të mbajtur më 25.06.2020, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" në nivel institucional për periudhën tre vjeçare, nga 01.09.2020 deri me 30.10.2023.
- II. Obligohet Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" që deri me datë 1 tetor 2020 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional.


AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtar të akreditimit në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti" më datë 20.05.2020, me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit më këtë përbërje: Prof. Milan Pol, Masaryk University, Prof. Janez Vogrinc, University of Ljubljana, Ms. Ketii Tsotniashvili, PhD Student (Student Expert).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 25.06.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, konstaton se Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", ka përmbushur substancialisht standardet e akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsej 11 kapituj të standardeve institucioni i plotëson plotësisht (4) standarde: Planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit; Hulumtimi; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional; Burimet dhe Hapësirat; Institucioni i plotëson substancialisht (6) standarde: Misioni publik dhe objektivat institucionale; Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Mësimdhënia dhe mësim nxënia; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse; Bashkëpunimi institucional; si dhe plotëson pjesërisht (1) standard: Menaxhimi i cilësisë.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Dr. Gëzim Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.